



## Seria 4: Statistikat e Popullsisë

# Ndryshimet demografike të popullsisë së Kosovës në periudhën 1948-2006







## Seria 4: Statistikat e Popullsisë

# Ndryshimet demografike të popullsisë së Kosovës në periudhën 1948-2006



Botuesi: Enti i Statistikës së Kosovës (ESK)  
Data e botimit: Shkurt 2008  
© : Enti i Statistikës së Kosovës  
Riprodhimi autorizohet nëse tregohet burimi.  
E shtypur nga: K.G.T, Prishtinë, Kosovë

Informata të shumta janë në dispozicion në internet,  
ku mund të qasenë përmes veb-faqes së ESK-së  
në internet: [www.ks-gov.net/esk](http://www.ks-gov.net/esk)

## **P a r a t h ë n i e**

Enti i Statistikës së Kosovës (ESK) përkatësisht departamenti i statistikave të Popullsisë (DSP) ka përgatitë publikimin “Ndryshimet demografike të popullsisë së Kosovës për periudhën 1948 – 2006” .

Të dhënat e publikuara në këtë publikim janë përfundimtare.

Në këtë publikim janë përfshi të dhënat për lindjet, vdekjet dhe shtimi natyral, në numra absolut dhe relative, ndërsa përlogaritjet e disa parametrave demografik, interpretimi i tyre dhe grafikonet janë bërë nga ekspertët e lëmisë përkatëse.

Të dhënat nga regjistrimet e popullsisë, janë marr nga publikime të veçanta të regjistrimeve, ndërsa të dhënat demografike janë grumbulluar nga të dhënat e statistikave vitale e në disa raste janë bërë vlerësime nga ESK.

Ky publikim i mundëson shfrytëzuesit të kenë qasje të shpejt dhe te lehtë për të gjitha regjistrimet e popullsisë të pas luftës së dytë botërore duke filluar nga 1948, '53, '61. '71, '81 '91\* dhe vlerësimit të vitit 2006, si dhe lëvizjet demografike të popullsisë së Kosovës për çdo vit.

Rëndësi të veçante ka ky publikim sepse të gjitha të dhënat janë paraqitur sipas etniciteteve të Kosovës numerikisht më të mëdha.

Në përgatitjen e këtij publikimi punuan: z. Kadri Sojeva, Drejtori i Departamentit të Statistikave të Popullsisë dhe znj. Sanije Uka, Shefe e Sektorit të Popullsisë.



## **P ë r m b a j t j a**

Definicionet.....	5
Popullsia e Kosovës dhe struktura e saj etnike sipas regjistrimeve të popullsisë .....	6
Norma mesatare e rritjes vjetore të popullsisë .....	10
Lindjet, vdekjet dhe shtimi natyral në Kosovë 1948 – 2006 .....	12
Shtimi natyral i popullsisë në Kosovë.....	12
Lindjet.....	15
Vdekjet.....	15
Shtimi natyral i shprehur në numra absolut.....	16
Nataliteti.....	17
Mortaliteti .....	17
Shtimi natyral i shprehur në numra relativ .....	17
Numri i popullsisë në Kosovë dhe struktura etnike sipas regjistrimit të popullsisë1981 dhe vlerësimit te vitit 1991 .....	18
Disa krahasime në mes regjistrimeve dhe shtimit natyral .....	18
Regjistrimi i vitit 1981 dhe përgatitjet për regjistrimin e ardhshëm .....	19





## Definicionet

### **Nataliteti**

Paraqet raportin në mes numrit të lindjeve të gjalla dhe numrit të popullsisë të të njëjtit vit në njëmijë banorë.

### **Mortaliteti**

Paraqet raportin në mes numrit të vdekjeve dhe numrit të popullsisë të të njëjtit vit në njëmijë banorë.

### **Shtimi natyral**

Paraqet ndryshimin në mes numrit të lindjeve të gjalla dhe numrit të vdekjeve, në raport me numrin e popullsisë të të njëjtit vit në njëmijë banorë.

### **Metodologjia e grumbullimit të të dhënave**

Të dhënat për lindjet dhe vdekjet mbledhen nga ofiqaritë. Sipas ligjit mbi librat amzë çdo ngjarje vitale, lindje apo vdekje, regjistrohet në selinë e ofiqarisë të vend-ngjarjes, pa marrë parasysh se personat në fjalë, vendbanimin e përhershëm e kanë në vendin ku ka ndodhur ngjarja, apo në ndonjë vend tjetër.

### **Lindjet e gjalla**

Lindje e gjallë konsiderohet foshnja e cila pas lindjes, qoftë edhe për kohën më të shkurtër tregon shenja jete, (frymëmarrje apo rrahje të zemrës) pa marrë parasysh kohëzgjatjen e shtatzënisë së nënës.

### **Lindjet e vdekura**

Nëse fëmija është lindur apo nxjerr nga trupi nënës pa asnjë shenjë të jetës siç është frymëmarrja, të rrahurat e zemrës apo lëvizjet e muskujve, por që nëna e ka bartur më gjatë se 28 javë, konsiderohet lindje e vdekur.

### **Etniciteti**

Përgjigjja në pyetjen për përkatësinë etnike është rezultat i deklaramit të lirë të qytetarëve, përkatësisht të prindërve (kujdestarëve) kur është fjala për fëmijët më të rinj se 10 vjet.

## Popullsia e Kosovës dhe struktura e saj etnike sipas regjistrimeve të popullsisë

Regjistrimi si operacion statistikor ofron gjendjen reale të popullsisë në një moment të caktuar dhe shërben si bazë për të bërë vlerësimet e mëvonshme demografike duke përdorur informacionin mbi shtimin natyral dhe saldot migruese.

Regjistrimet e përgjithshme të popullsisë në Kosovë datojnë që nga viti 1921. Regjistrimet e viteve 1921 dhe 1931 nuk kanë grumbulluar informacione për etnicitetet dhe strukturën e tyre, por kanë ofruar informata për numrin e tërësishëm të popullsisë dhe përkatësinë fetare.

Struktura etnike e popullsisë për herë të parë është realizuar me regjistrimin e vitit 1948. Përgjigja në pyetjen për përkatësinë etnike është rezultat i deklaramit të lirë të qytetarëve, përkatësisht të prindërve (kujdestarëve) për fëmijët më të rinj se 10 vjeç, kurse në regjistrimet e vitit 1971, 1981 dhe 1991 më të rinj se 15 vjeç.

Në këtë punim ESK ka paraqitur të dhënat për 4 etnicitete numerikisht më të mëdha në Kosovë: shqiptarë, serbë, turq dhe rom. Ndërsa, në kolonën-grupin të tjera janë përfshirë të gjitha etnitë tjera që jetojnë në Kosovë.

Duke u bazuar në rezultatet e regjistrimeve të popullsisë në Kosovë, prej vitit 1948 deri 1991 vërehet se ka pasur një *shpërputhje* në aspektin demografik, krahasuar me shtimin natyral dhe regjistrimeve të popullsisë.

Kështu, nëse marrim regjistrimin e vitit 1948-1952, dhe kur atij numri i shtohet shtimi natyral i popullsisë ndërmjet dy regjistrimeve (94,633) fitohet numri i pritur prej 827,667 banorë. Kur, ky numër krahasohet me numrin e popullsisë në regjistrimin e vitit 1953, shohim se paraqitet ndryshimi prej 11,759 banorë. Sipas strukturës etnike shihet se mungojnë në regjistrim: 38,032 shqiptarë, 2,492 serbë, 745 rom, dhe 3,571 të tjerë, derisa numri i turqve është rritur për 33,081 banorë.

**Tabela nr.1**

Vitet e regjistrimeve	Gjithsej	Shqiptarë	Serbë	Turq	Rom	Të tjerë
Regjistrimi - 1948	733.034	498.244	176.718	1.320	11.230	45.522
Shtimi natyral 1948-52	94.633	64.350	22.807	189	1.419	5.868
Është dashur të jetë	827.667	562.594	199.525	1.509	12.649	51.390
Regjistrimi - 1953	815.908	524.562	197.033	34.590	11.904	47.819
Mungojne ne regjistrim	-11.759	-38.032	-2.492	33.081	-745	-3.571

Numri i popullsisë dhe struktura etnike gjatë regjistrimeve ndryshon nga regjistrimi në regjistrim, duke u bazuar në shtimin natyral dhe lëvizjeve mekanike të popullsisë.

Në vitin 1921 Kosova kishte 439,010 banorë. Në këtë regjistrim siç u theksua nuk është dhënë përkatësia etnike e popullsisë.

Dhjetë vite më vonë, në vitin 1931 Kosova kishte 552,064 banorë, pra kishte një rritje të popullsisë prej 113,054 banorë, apo 25.8% më shumë se në vitin 1921.

Në vitin 1941 nuk kishte regjistrim të popullsisë për shkaqe të luftës së dytë botërore (1941-1945) derisa regjistrimi pasues është mbajtur në vitin 1948 pra pas 17 viteve.

Në vitin 1948 Kosova kishte 733,034 banorë, dhe kishte një rritje të popullsisë prej 180,970 banorë, apo 32,8% më shumë se në vitin 1931.

Në vitin 1953 bëhet regjistrimi i popullsisë, Kosova kishte 815,908 banorë, me një rritje të popullsisë prej 82,874 banorë, apo 11,3% më shumë se në vitin 1948.

Në vitin 1961 bëhet regjistrimi i popullsisë, Kosova kishte 963,988 banorë, dhe kishte një rritje të popullsisë prej 148,080 banorë, apo 18.1% më shumë se në vitin 1953.

Në vitin 1971 bëhet regjistrimi i popullsisë, Kosova kishte 1.243,693 banorë, dhe kishte një rritje të popullsisë prej 279,705 banorë, apo 29% më shumë se në vitin 1961.

Në vitin 1981 bëhet regjistrimi i popullsisë, Kosova kishte 1.584.440 banorë, dhe kishte një rritje të popullsisë prej 340,747 banorë, apo 27.4% më shumë se në vitin 1971.

Në vitin 1991 bëhet vlerësimi i popullsisë, Kosova kishte 1.956,196 banorë<sup>1</sup>, dhe kishte një rritje të popullsisë prej 371.756 banorë, apo 23.5% më shumë se në vitin 1981.

Në vitin 2006 Kosova është dashur ti ketë rreth 2.100.000 banorë<sup>2</sup>, d.m.th kishte një rritje të popullsisë prej 143.804 banorë, apo 7.4% më shumë se në vitin 1991.

**Tabela nr.2**

Popullsia e Kosoves sipas perberjes etnike- 1921-2006						
Vitet e regjistrimit	Gjithsej	Shqiptarë	Serbë	Turq	Rom	Të tjerë
1921	439.010	—	—	—	—	—
1931	552.064	—	—	—	—	—
1948	733.034	498.244	176.718	1.320	11.230	45.522
%	100	68,0	24,1	0,2	1,5	6,2
1953	815.908	524.562	189.869	34.590	11.904	54.983
%	100	64,3	23,3	4,2	1,5	6,7
1961	963.988	646.605	227.016	25.764	3.202	61.401
%	100	67,1	23,5	2,7	0,3	6,4
1971	1.243.693	916.168	228.264	12.244	14.593	72.424
%	100	73,7	18,4	1,0	1,2	5,8
1981	1.584.440	1.226.736	209.798	12.513	34.126	101.267
%	100	77,4	13,2	0,8	2,2	6,4
1991	1.956.196	1.596.072	194.190	10.445	45.745	109.744
%	100	81,6	9,9	0,5	2,3	5,6
2006	2.100.000	1.932.000	111.300	8.400	23.512	24.788
%	100.0%	92	5,3	0,4	1,1	1,2

Për vitet 1948, 1953, 1961, 1971, dhe 1981, te dhenat jane nxjerrur nga publikimet e regjistrimeve.


Për vitin 1991, të dhënat janë vlerësim i EFS

Për vitin 2006, vlerësim i ESK-së

<sup>1</sup> Vlerësim i Entit Federativ i Statistikës së-Jugosllavisë.

<sup>2</sup> Për vitin 2006 numri i popullsisë së Kosovës është vlerësim i ESK- duke u mbështetur në metodologjinë e re: popullsi rezidente dhe jorezidente.

Grafikoni nr.1



Siç shihet nga tabela nr.2 dhe grafikoni nr. 1, Kosova ka pasur një trend të vazhdueshëm të rritjes së popullsisë në numra absolut. Rritja më e madhe ishte në periudhën 1981-1991, për 371,756 banorë.

Rritja më e vogël e numrit të banorëve në Kosovë, në periudhën pas luftës së dytë botërore u paraqit në mes viteve 1991-2006 me vetëm 143,804 banorë (për shkak të ndryshimit të definicionit të popullsisë rezidente)

Të dhënat nga tabela nr.1 tregojnë se etniciteti shqiptarë kishte numrin më të madh të popullsisë në vitin 2006 me rreth 1.932.000 banorë apo 92.0%.

Etniciteti serbë kishte numrin më të madh të popullsisë në vitin 1971 me 228.264 banorë apo 18.4%.

Etniciteti turk kishte numrin më të madh të popullsisë në vitin 1953 me rreth 34.590 banorë apo 4.2%.

Etniciteti rom<sup>3</sup> kishte numrin më të madh të popullsisë në vitin 1991 me rreth 45.745 banorë apo 2.3%.

Në vitet e regjistrimeve të popullsisë, struktura etnike ka ndryshuar prej regjistrimit në regjistrim.

*Etniciteti shqiptarë* në vitin 1948 përbënte 68% të numrit të përgjithshëm të popullsisë në Kosovë, në vitin 1991 (vlerësim i Entit Federativ Statistikor të ish Jugosllavisë) 81,6%, ndërsa në vitin 2006 është 92% (vlerësim i ESK-së) .

*Etniciteti serbë* në vitin 1948 përbënte 24.1% të numrit të përgjithshëm të popullsisë në Kosovë, në vitin 1991 përbënte 9.9%, ndërsa në vitin 2006 është 5.3% (vlerësim i ESK-së) .

*Etniciteti turk* në vitin 1948 përbënte 0.2% të numrit të përgjithshëm të popullsisë në Kosovë, në vitin 1991 (vlerësim i Entit Federativ Statistikor të ish Jugosllavisë) 0.5%, ndërsa në vitin 2006 është 0.4% (vlerësim i ESK-së) .


*Etniciteti rom* në vitin 1948 përbënte 1.5% të numrit të përgjithshëm të popullsisë në Kosovë, në vitin 1991 2.3%, ndërsa në vitin 2006 është 1.1% (vlerësim i ESK-së) .

<sup>3</sup> Vlerësim i EFS


Në regjistrimet deri në vitin 1981, pjesëmarrja e etnicitetit shqiptarë nëpër komisione të regjistrimeve ishte shumë e vogël.

Nëse shikohet struktura etnike që nga viti 1948 – 2006 shihen oscilime (lëvizje) sa i përket numrit të popullsisë së etnive nëpër regjistrime, me përjashtim të shqiptarëve që kanë trend të rritjes graduale.


**Grafikoni nr.2**




**Grafikoni nr.3**




**Grafikoni nr.4**



**Grafikoni nr.5**



**Grafikoni nr.6**



Është karakteristike se etniteti turk shënon një rritje enorme në vitin 1953, me gjithsej 34.590 banorë, krahasuar me të dhënat e regjistrimit të vitit 1948, që kishte vetëm 1,320 banorë. Po ashtu, tek romët kishte oscilime të theksuara në mes të viteve 1953, 1961 dhe 1971.

### Norma mesatare e rritjes vjetore të popullsisë

Për ndryshim, regjistrimi i popullsisë, i cili paraqet fotografinë reale të numrit të popullsisë në një moment të caktuar (momenti kritik), shtimi natyral paraqet ndryshimin në mes të lindjeve të gjalla dhe vdekjeve për çdo vit.

Norma vjetore e popullsisë paraqet rritjen apo zvogëlimin e lëvizjeve të popullsisë vite për vite.

**Tabela nr.3**

Periudha e regjistrimeve	Norma e shtimit
1921-1931	2.3
1931-1948	1.7
1948-1953	2.2
1953-1961	2.1
1961-1971	2.6
1971-1981	2.5
1981-1991	2.1

Norma mesatare e rritjes vjetore të popullsisë më e larta ishte në periudhën 1961-1971 , me 2.6%.

Norma mesatare e rritjes vjetore popullsisë më e ulëta ishte në periudhën 1931-1948 , me 1.7%.

Grafikoni nr.7




Tabela nr.4

Indeksi vargor<sup>4</sup> sipas regjistrimeve dhe struktura etnike

Vitet e regjistrimit	Gjithsej	Shqiptarë	Serbë	Turq	Rom	Të tjerë
1921	—					
1931	125,8					
1948	132,8	—	—	—	—	—
1953	111,3	105,3	107,4	2620,5	106,0	120,8
1961	118,1	123,3	119,6	74,5	26,9	111,7
1971	129,0	141,7	100,5	47,5	455,7	118,0
1981	127,4	133,9	91,9	102,2	233,9	139,8
1991	123,5	130,1	92,6	83,5	134,0	108,4
2006	107,4	121,0	57,3	80,4	51,4	22,6

Sipas strukturës etnike shtimin më të madh të popullsisë në numra absolut, etniteti shqiptarë ndërmjet dy regjistrimeve e kishte në vitin 1991. Rritja në numra absolut ishte 369,336 banorë.

Shtimin më të madh të popullsisë në numra absolut ndërmjet dy regjistrimeve, etniteti serbë e ka pasur në vitin 1961, me 37,147 banorë.

Shtimin më të madhe të popullsisë në numra absolut ndërmjet dy regjistrimeve, etniteti turk e ka pasur në vitin 1981, me 19,533 banorë.

Shtimin më të madhe të popullsisë në numra absolut ndërmjet dy regjistrimeve, etniteti rom e ka pasur në vitin 1981 me 19,533 banorë.

<sup>4</sup> Indeksi vargor paraqet raportin e secilës madhësi raportuese të serisë ndaj madhësisë paraprake si bazë.

## **Lindjet, vdekjet, dhe shtimi natyral në Kosovë 1948 – 2006**

Enti i Statistikave së Kosovës (ESK), përkatësisht Departamenti i Statistikave të Popullsisë (DSP), ka bërë *përmbledhjen* e të dhënave demografike për lindjet, vdekjet, dhe shtimin natyral në nivel të Kosovës, sipas përkatësisë etnike për periudhën 1948 – 2006.

Përkatësitë etnike në këtë punim, për periudhën e përmendur janë: shqiptarët, serbët, turqit dhe romët.

Burimi i të dhënave për këtë punim, ishin publikimet e ESK-së dhe librat e Statistikave Demografike, të publikuara nga Enti Federativ i Statistikës së ish Jugosllavisë (EFS), për vitet përkatëse.

### **Shtimi natyral i popullsisë në Kosovë.**

Në këtë publikim janë të prezantuara lindjet (e gjalla), vdekjet dhe shtimi natyral për periudhën nga viti 1948 e deri më 2006.

Të dhënat **gjithsej** janë të dhëna statistikore zyrtare të publikuara nëpër vitet përkatëse.

Përpunimi i të dhënave për lindje dhe vdekje sipas strukturës etnike ka filluar të përpunohet nga viti 1956<sup>5</sup>.

Të dhënat për vitet 1998-2001 janë të vlerësuara nga ESK<sup>6</sup>, sepse për këtë periudhë nuk janë grumbulluar të dhënat zyrtare. Te dhënat kanë filluar të grumbullohen nga viti 2002.

---

<sup>5</sup> Në mungesë të këtyre të dhënave zyrtare statistikore, ESK ka bërë vlerësimin sipas strukturës etnike për periudhën 1948 -1955 ;1965-1969; 1990-2001

<sup>6</sup> Të dhënat për vitet 1998-2001 nuk janë grumbulluar -shkaku i luftës dhe riorganizimi i ESK



Ndryshimet demografike të popullsisë së Kosovës në periudhën 1948-2006

Tabela nr. 5

Viti	Lindjet, vdekjet dhe shtimi natyral ne Kosove sipas viteve dhe etnicitetit																	
	Lindjet						Vdekjet						Shtimi natyral					
	Gjithsej	Shqiptarë	Serbë	Turq	Rom	Të tjerë	Gjithsej	Shqiptarë	Serbë	Turq	Rom	Të tjerë	Gjithsej	Shqiptarë	Serbë	Turq	Rom	Të tjerë
1948	27792	18899	6698	56	417	1723	10324	7020	2488	21	155	640	17468	11878	4210	35	262	1083
1949	31643	21517	7626	63	475	1962	12927	8790	3115	26	194	801	18716	12727	4511	37	281	1160
1950	35222	23951	8489	70	528	2184	12991	8834	3131	26	195	805	22231	15117	5358	44	333	1378
1951	29299	19923	7061	59	439	1817	14833	10086	3575	30	222	920	14466	9837	3486	29	217	897
1952	35619	24221	8584	71	534	2208	13867	9430	3342	28	208	860	21752	14791	5242	44	326	1349
1953	34595	23525	8337	69	519	2145	16726	11374	4031	33	251	1037	17869	12151	4306	36	268	1108
1954	38595	26245	9301	77	579	2393	13201	8977	3181	26	198	818	25394	17268	6120	51	381	1574
1955	36736	24980	8853	73	551	2278	15292	10399	3685	31	229	948	21444	14582	5168	43	322	1330
1956	37819	27950	5230	420	0	4219	13692	10349	2399	249	0	695	24127	17601	2831	171	0	3524
1957	34159	23997	7114	697	0	2351	15300	11996	2365	252	0	687	18859	12001	4749	445	0	1664
1958	39285	28452	7513	641	0	2679	11598	8885	1901	212	0	600	27687	19567	5612	429	0	2079
1959	37364	26707	7339	409	0	2909	12878	9860	2188	141	0	689	24486	16847	5151	268	0	2220
1960	41631	30545	7509	387	0	3190	13365	10426	2114	135	0	690	28266	20119	5395	252	0	2500
1961	40561	29931	7115	316	0	3199	11759	9139	1931	102	0	587	28802	20792	5184	214	0	2612
1962	41366	26710	6156	275	0	8225	15024	11776	2368	137	0	743	26342	14934	3788	138	0	7482
1963	41525	31706	6463	321	0	3035	12423	9803	1845	107	0	668	29102	21903	4618	214	0	2367
1964	42557	32748	6473	323	0	3013	12731	10219	1774	98	0	640	29826	22529	4699	225	0	2373
1965	43569	34594	5795	305	131	2745	11767	9308	1752	77	0	630	31802	25286	4043	228	131	2115
1966	42429	33689	5770	297	127	2546	10266	8241	1440	75	61	449	32163	25448	4330	222	66	2097
1967	44001	34937	5984	308	132	2640	11308	9070	1636	81	57	464	32693	25867	4348	227	75	2176
1968	44627	35434	6069	312	134	2678	10781	8557	1709	86	49	380	33846	26877	4360	226	85	2298
1969	46480	36905	6321	325	139	2789	10892	8539	1714	89	64	486	35588	28366	4607	236	75	2303
1970	44496	36409	5030	296	260	2501	10829	8246	1792	95	59	637	33667	28163	3238	201	201	1864
1971	47060	38923	5111	213	352	2461	10312	7979	1558	87	60	628	36748	30944	3553	126	292	1833
1972	47943	39936	4990	222	363	2432	10270	7845	1702	48	60	615	37673	32091	3288	174	303	1817
1973	47714	39647	4984	243	419	2421	10358	7963	1527	62	57	749	37356	31684	3457	181	362	1672
1974	49847	41733	4944	245	509	2416	10075	7906	1473	63	69	564	39772	33827	3471	182	440	1852
1975	49310	41334	4870	298	479	2329	10018	7792	1528	50	64	584	39292	33542	3342	248	415	1745
1976	51355	43379	4819	278	506	2373	10149	7945	1530	64	67	543	41206	35434	3289	214	439	1830
1977	49849	42244	4549	263	545	2248	9811	7646	1460	56	76	573	40038	34598	3089	207	469	1675
1978	49027	41663	4368	242	567	2187	9776	7642	1459	64	92	519	39251	34021	2909	178	475	1668
1979	48125	41255	4012	235	434	2189	9575	7368	1507	40	94	566	38550	33887	2505	195	340	1623
1980	53147	45584	4256	254	709	2344	8909	6846	1368	67	93	535	44238	38738	2888	187	616	1809
1981	48111	41263	3675	228	714	2231	9677	7457	1445	60	119	596	38434	33806	2230	168	595	1635
1982	52865	45288	4140	229	821	2387	10479	7925	1687	66	153	648	42386	37363	2453	163	668	1739
1983	49645	42400	3778	175	674	2618	11040	8501	1583	48	115	793	38605	33899	2195	127	559	1825
1984	55243	47172	4065	264	1083	2659	10573	8017	1551	75	155	775	44670	39155	2514	189	928	1884
1985	53925	46309	3714	311	916	2675	11826	8905	1801	69	165	886	42099	37404	1913	242	751	1789
1986	54519	47087	3636	315	1024	2457	10446	7819	1585	81	199	762	44073	39268	2051	234	825	1695
1987	56221	48830	3645	290	1135	2321	10307	7864	1576	60	201	606	45914	40966	2069	230	934	1715
1988	56283	49063	3454	245	1131	2390	10257	7770	1608	57	167	655	46026	41293	1846	188	964	1735
1989	53656	46809	3242	236	1106	2263	10181	7637	1654	66	205	619	43475	39172	1588	170	901	1644
1990	55175	47865	3458	270	1111	2471	8214	5840	1437	45	175	717	46961	42025	2021	225	936	1754
1991	52263	45313	3368	266	1010	2306	8526	6432	1324	54	152	565	43737	38881	2044	212	859	1741
1992	44418	38511	2862	226	859	1960	8004	6038	1242	50	142	530	36414	32473	1620	176	716	1429
1993	44132	38263	2844	225	853	1947	7804	5888	1211	49	139	517	36328	32376	1632	176	714	1430
1994	43450	37672	2800	221	840	1917	7667	5784	1190	48	136	508	35783	31888	1610	173	704	1409
1995	44776	38822	2885	228	866	1975	8671	5749	2030	69	222	601	36105	33073	855	159	644	1374
1996	46041	39918	2967	234	890	2031	8392	5482	2008	55	166	681	37649	34436	959	179	724	1350
1997	42920	37212	2766	219	830	1894	8624	6506	1339	54	153	571	34296	30706	1427	164	676	1322
1998	41752	36324	2463	251	960	1754	8123	6450	1295	18	48	312	33629	29874	1168	233	912	1442
1999	40020	34817	2361	240	920	1682	7569	5870	1124	15	50	510	32451	28947	1237	225	870	1172
2000	38687	36658	6	232	290	1501	7115	6720	48	17	46	284	31572	29938	-42	215	244	1217
2001	37412	35548	4	224	320	1316	6672	6071	44	22	42	493	30740	29477	-40	202	278	823
2002	36136	35174	5	100	316	541	5654	5357	32	18	38	209	30482	29817	-27	82	278	332
2003	31994	30917	18	125	380	554	6417	5987	119	16	40	255	25577	24930	-101	109	340	299
2004	35063	33812	3	153	432	663	6399	6137	81	12	30	139	28664	27675	-78	141	402	524
2005	37218	35982	4	175	430	627	7207	6825	118	13	31	220	30011	29157	-114	162	399	407
2006	34187	32977	8	156	247	799	7479	7072	96	29	25	257	26708	25905	-88	127	222	542
	2570859	2119679	269905	14503	30007	136766	617350	472359	99817	3924	5789	35461	1953509	1647320	170088	10579	24218	101305
	100	82,5	10,5	0,6	1,2	5,3	100	76,5	16,2	0,6	0,9	5,7	100	84,3	8,7	0,5	1,2	5,2

Për vitet 1948 - 1955 dhe 1965 - 1969, të dhënat për lindjet, nuk janë përpunuar sipas pëkatësise etnike të nënës.  
Për vitet 1948 - 1955 dhe 1966 - 1969, të dhënat për vdekjet, nuk janë përpunuar sipas pëkatësise etnike të të vdekurit.  
Për vitet 1991-1997 struktura etnike për lindje është vlerësim i ESK dhe për vdekje për periudhën 1991-1994  
Për vitet 1998-2001 është vlerësim i ESK, për: lindje dhe vdekje  
Burimi: 1990-1997 "Statistikat vitale të Kosovës, për vitin 2004", faqe 7

Ndryshimet demografike të popullsisë së Kosovës në periudhën 1948-2006

Tabela nr.6

Struktura etnike për lindje, vdekje, dhe shtimi natyror sipas viteve																		
Viti	Lindjet						Vdekjet						Shtimi natyral					
	Gjithsej	Shqiptarë	Serbë	Turq	Rom	Të tjerë	Gjithsej	Shqiptarë	Serbë	Turq	Rom	Të tjerë	Gjithsej	Shqiptarë	Serbë	Turq	Rom	Të tjerë
1948	100	68,0	24,1	0,2	1,5	6,2	100	68,0	24,1	0,2	1,5	6,2	100	68,0	24,1	0,2	1,5	6,2
1949	100	68,0	24,1	0,2	1,5	6,2	100	68,0	24,1	0,2	1,5	6,2	100	68,0	24,1	0,2	1,5	6,2
1950	100	68,0	24,1	0,2	1,5	6,2	100	68,0	24,1	0,2	1,5	6,2	100	68,0	24,1	0,2	1,5	6,2
1951	100	68,0	24,1	0,2	1,5	6,2	100	68,0	24,1	0,2	1,5	6,2	100	68,0	24,1	0,2	1,5	6,2
1952	100	68,0	24,1	0,2	1,5	6,2	100	68,0	24,1	0,2	1,5	6,2	100	68,0	24,1	0,2	1,5	6,2
1953	100	68,0	24,1	0,2	1,5	6,2	100	68,0	24,1	0,2	1,5	6,2	100	68,0	24,1	0,2	1,5	6,2
1954	100	68,0	24,1	0,2	1,5	6,2	100	68,0	24,1	0,2	1,5	6,2	100	68,0	24,1	0,2	1,5	6,2
1955	100	68,0	24,1	0,2	1,5	6,2	100	68,0	24,1	0,2	1,5	6,2	100	68,0	24,1	0,2	1,5	6,2
1956	100	73,9	13,8	1,1	0,0	11,2	100	75,6	17,5	1,8	0,0	5,1	100	73,0	11,7	0,7	0,0	14,6
1957	100	70,3	20,8	2,0	0,0	6,9	100	78,4	15,5	1,6	0,0	4,5	100	63,6	25,2	2,4	0,0	8,8
1958	100	72,4	19,1	1,6	0,0	6,8	100	76,6	16,4	1,8	0,0	5,2	100	70,7	20,3	1,5	0,0	7,5
1959	100	71,5	19,6	1,1	0,0	7,8	100	76,6	17,0	1,1	0,0	5,4	100	68,8	21,0	1,1	0,0	9,1
1960	100	73,4	18,0	0,9	0,0	7,7	100	78,0	15,8	1,0	0,0	5,2	100	71,2	19,1	0,9	0,0	8,8
1961	100	73,8	17,5	0,8	0,0	7,9	100	77,7	16,4	0,9	0,0	5,0	100	72,2	18,0	0,7	0,0	9,1
1962	100	64,6	14,9	0,7	0,0	19,9	100	78,4	15,8	0,9	0,0	4,9	100	56,7	14,4	0,5	0,0	28,4
1963	100	76,4	15,6	0,8	0,0	7,3	100	78,9	14,9	0,9	0,0	5,4	100	75,3	15,9	0,7	0,0	8,1
1964	100	77,0	15,2	0,8	0,0	7,1	100	80,3	13,9	0,8	0,0	5,0	100	75,5	15,8	0,8	0,0	8,0
1965	100	79,4	13,3	0,7	0,3	6,3	100	79,1	14,9	0,7	0,0	5,4	100	79,5	12,7	0,7	0,4	6,7
1966	100	79,4	13,6	0,7	0,3	6,0	100	80,3	14,0	0,7	0,6	4,4	100	79,1	13,5	0,7	0,2	6,5
1967	100	79,4	13,6	0,7	0,3	6,0	100	80,2	14,5	0,7	0,5	4,1	100	79,1	13,3	0,7	0,2	6,7
1968	100	79,4	13,6	0,7	0,3	6,0	100	79,4	15,9	0,8	0,5	3,5	100	79,4	12,9	0,7	0,3	6,8
1969	100	79,4	13,6	0,7	0,3	6,0	100	78,4	15,7	0,8	0,6	4,5	100	79,7	12,9	0,7	0,2	6,5
1970	100	81,8	11,3	0,7	0,6	5,6	100	76,1	16,5	0,9	0,5	5,9	100	83,7	9,6	0,6	0,6	5,5
1971	100	82,7	10,9	0,5	0,7	5,2	100	77,4	15,1	0,8	0,6	6,1	100	84,2	9,7	0,3	0,8	5,0
1972	100	83,3	10,4	0,5	0,8	5,1	100	76,4	16,6	0,5	0,6	6,0	100	85,2	9,7	0,5	0,8	4,8
1973	100	83,1	10,4	0,5	0,9	5,1	100	76,9	14,7	0,6	0,6	7,2	100	84,8	9,3	0,5	1,0	4,5
1974	100	83,7	9,9	0,5	1,0	4,8	100	78,5	14,6	0,6	0,7	5,6	100	85,1	8,7	0,5	1,1	4,7
1975	100	83,8	9,9	0,6	1,0	4,7	100	77,8	15,3	0,5	0,6	5,8	100	85,4	8,5	0,6	1,1	4,4
1976	100	84,5	9,4	0,5	1,0	4,6	100	78,3	15,1	0,6	0,7	5,4	100	86,0	8,0	0,5	1,1	4,4
1977	100	84,7	9,1	0,5	1,1	4,5	100	77,9	14,9	0,6	0,8	5,8	100	86,4	7,7	0,5	1,2	4,2
1978	100	85,0	8,9	0,5	1,2	4,5	100	78,2	14,9	0,7	0,9	5,3	100	86,7	7,4	0,5	1,2	4,2
1979	100	85,7	8,3	0,5	0,9	4,5	100	77,0	15,7	0,4	1,0	5,9	100	87,9	6,5	0,5	0,9	4,2
1980	100	85,8	8,0	0,5	1,3	4,4	100	76,8	15,4	0,8	1,0	6,0	100	87,6	6,5	0,4	1,4	4,1
1981	100	85,8	7,6	0,5	1,5	4,6	100	77,1	14,9	0,6	1,2	6,2	100	88,0	5,8	0,4	1,5	4,3
1982	100	85,7	7,8	0,4	1,6	4,5	100	75,6	16,1	0,6	1,5	6,2	100	88,1	5,8	0,4	1,6	4,1
1983	100	85,4	7,6	0,4	1,4	5,3	100	77,0	14,3	0,4	1,0	7,2	100	87,8	5,7	0,3	1,4	4,7
1984	100	85,4	7,4	0,5	2,0	4,8	100	75,8	14,7	0,7	1,5	7,3	100	87,7	5,6	0,4	2,1	4,2
1985	100	85,9	6,9	0,6	1,7	5,0	100	75,3	15,2	0,6	1,4	7,5	100	88,8	4,5	0,6	1,8	4,2
1986	100	86,4	6,7	0,6	1,9	4,5	100	74,9	15,2	0,8	1,9	7,3	100	89,1	4,7	0,5	1,9	3,8
1987	100	86,9	6,5	0,5	2,0	4,1	100	76,3	15,3	0,6	2,0	5,9	100	89,2	4,5	0,5	2,0	3,7
1988	100	87,2	6,1	0,4	2,0	4,2	100	75,8	15,7	0,6	1,6	6,4	100	89,7	4,0	0,4	2,1	3,8
1989	100	87,2	6,0	0,4	2,1	4,2	100	75,0	16,2	0,6	2,0	6,1	100	90,1	3,7	0,4	2,1	3,8
1990	100	86,8	6,3	0,5	2,0	4,5	100	71,1	17,5	0,5	2,1	8,7	100	89,5	4,3	0,5	2,0	3,7
1991	100	86,7	6,4	0,5	1,9	4,4	100	75,4	15,5	0,6	1,8	6,6	100	88,9	4,7	0,5	2,0	4,0
1992	100	86,7	6,4	0,5	1,9	4,4	100	75,4	15,5	0,6	1,8	6,6	100	89,2	4,4	0,5	2,0	3,9
1993	100	86,7	6,4	0,5	1,9	4,4	100	75,4	15,5	0,6	1,8	6,6	100	89,1	4,5	0,5	2,0	3,9
1994	100	86,7	6,4	0,5	1,9	4,4	100	75,4	15,5	0,6	1,8	6,6	100	89,1	4,5	0,5	2,0	3,9
1995	100	86,7	6,4	0,5	1,9	4,4	100	66,3	23,4	0,8	2,6	6,9	100	91,6	2,4	0,4	1,8	3,8
1996	100	86,7	6,4	0,5	1,9	4,4	100	65,3	23,9	0,7	2,0	8,1	100	91,5	2,5	0,5	1,9	3,6
1997	100	86,7	6,4	0,5	1,9	4,4	100	75,4	15,5	0,6	1,8	6,6	100	89,5	4,2	0,5	2,0	3,9
1998	100	87,0	5,9	0,6	2,3	4,2	100	79,4	15,9	0,2	0,6	3,8	100	88,8	3,5	0,7	2,7	4,3
1999	100	87,0	5,9	0,6	2,3	4,2	100	77,6	14,9	0,2	0,7	6,7	100	89,2	3,8	0,7	2,7	3,6
2000	100	94,8	0,0	0,6	0,7	3,9	100	94,4	0,7	0,2	0,6	4,0	100	94,8	-0,1	0,7	0,8	3,9
2001	100	95,0	0,0	0,6	0,9	3,5	100	91,0	0,7	0,3	0,6	7,4	100	95,9	-0,1	0,7	0,9	2,7
2002	100	97,3	0,0	0,3	0,9	1,5	100	94,7	0,6	0,3	0,7	3,7	100	97,8	-0,1	0,3	0,9	1,1
2003	100	96,6	0,1	0,4	1,2	1,7	100	93,3	1,9	0,2	0,6	4,0	100	97,5	-0,4	0,4	1,3	1,2
2004	100	96,4	0,0	0,4	1,2	1,9	100	95,9	1,3	0,2	0,5	2,2	100	96,5	-0,3	0,5	1,4	1,8
2005	100	96,7	0,0	0,5	1,2	1,7	100	94,7	1,6	0,2	0,4	3,1	100	97,2	-0,4	0,5	1,3	1,4
2006	100	96,5	0,0	0,5	0,7	2,3	100	94,6	1,3	0,4	0,3	3,4	100	97,0	-0,3	0,5	0,8	2,0

## Lindjet

Të dhënat për lindjet e gjalla për periudhën raportuese tregojnë trend të rritjes. Në vitin 1948 kishte 27,792 lindje të gjalla. Rritje më të theksuar kishte në vitet 1982-1991, ku maksimumi është në vitin 1988 me 56,283 lindje. Që nga viti 1992 fillon rënia e lindjeve, duke arritur në vitin 2006 në 34,187 lindje të gjalla.

*Etniciteti shqiptar* në vitin 1948 duhej ti kishte rreth 18,899 lindje të gjalla (vlerësim i ESK-së<sup>7</sup>), duke vazhduar rritja, ku pika më e lartë arrihet në vitin 1988 me 49,063 lindje, që do të thotë 159.6%.

Që nga viti 1989 fillon një rënie e lindjeve. Nga ky vit kishte rënie të lindjeve me gjithsej 46,809, në përqindje 4.6. Rënia vazhdoi deri më 2006, ku shënohen gjithsej 32,977 lindje, në përqindje 29.6.

*Etniciteti serbë* në vitin 1948 duhej të kishte rreth 6,698 lindje të gjalla (vlerësim i ESK-së), me trend të rritjes deri në vitin 1954 ku shënon rritjen më të madhe me 9,301 lindje të gjalla apo 38.9%. Mandej fillon rënia e lindjeve.

Në vitin 1999 sipas vlerësimit të ESK etniciteti serbë duhej të kishte rreth 2,361 lindje të gjalla apo me një rënie prej 74.6%.

*Etniciteti turk* në vitin 1948 kishte rreth 56 lindje, me trend rritjeje enorme, ku në vitin 1957 arrin rritjen më të madhe me 697 apo një rritje prej 1144%. Prej atëherë fillon rënia për të vazhduar deri në vitin 2006 me 156 lindje, me rënie prej 77.6%.

*Etniciteti rom* sipas publikimeve të ESK-së në vitin 1948 kishte 417 lindje të gjalla, për të vazhduar me rritje deri në vitin 1987 me 1135 lindje të gjalla, apo kishte rritje prej 172.2% pastaj fillon një rënie deri më 2006, me 247 lindje apo rënie prej 78.2%.

Të dhënat e mësipërme tregojnë ekstremet (minimumi dhe maksimumi) e lindjeve të gjalla nga viti 1948 deri në vitin 2006.

## Vdekjet

Në vitin 1948 vdekjet gjithsej ishin 10,324. Shënohet një rritje për të arritur numrin më të madh të vdekjeve në vitin 1953 me 16,726 vdekje. Pastaj fillon të shënohet një rënie deri në vitin 1966 dhe aty pothuaj stagnon për dhjetë vite. Në vitet 1977-1990 ka oscilime në mes 9.000 dhe 11.000 vdekjeve në vit.

Prej vitit 1990 numri i vdekjeve në Kosovë ka tendencë zvogëlimi ku në vitin 2006 regjistrohen 7.479 raste të vdekjeve.

Etniciteti shqiptar në vitin 1948 kishte 7,020 vdekje. Prej atëherë shënohet rritje e vdekjeve, për të arritur në vitin 1957 me 11,996 vdekje. Në vitet e mëvonshme shënohet një rënie për të arritur në vitin 2006 me 7,072 vdekje natyrale.

Etniciteti serb në vitin 1948 kishte 2,488 raste të vdekjes. Vdekshmëria më e lartë u shënuar në vitin 1953, ku u regjistruan 4,031 vdekje.

Etniciteti turk në vitin 1948 kishte 21 vdekje, rritje shënohet në vitin 1957 me 252 vdekje. Nga viti 1957 fillon trendi i rënies deri në vitin 2006 ku kishte 29 raste të vdekjeve.

---

<sup>7</sup> Në baze të mesatares arithmetikore

Etniciteti rom në vitin 1948 kishte 155 vdekje sipas vlerësimit të ESK-së. Rritja më e madhe shënohet në vitin 1989, ku regjistrohen 205 raste. Prej atëherë e deri më vitin 2006 vazhdon rënia me 25 raste vdekjesh.

### **Shtimi natyral i shprehur në numra absolut**

Shtimi natyral i popullsisë në Kosovës që nga viti 1948 e deri më 2006 në numra absolut ishte 1,953,509 banorë.

Pjesëmarrja e etniteteve në këtë numër është: shqiptarë 1,647,320 apo 84.3%, serbë 170,088 apo 8.7%, turqi 10,579 apo 0.5 % , romët 24,218 apo 1.2% dhe të tjerët 101,305 apo 5.2%.

Shtimi natyral ka tendencë rritjeje në Kosovë. Në vitin 1948 shtimi natyral ishte 17,468. Shtimi natyral ka rrjedhë të vazhdueshme të rritjes deri në vitet e '90-ta ku arrin rritjen më të madhe me 46,961 persona.

Që nga ky vit shtimi natyral fillon të bie, e që në vitin 2006 ishte 26,708 persona.

Shtimi natyral tek *etniteti shqiptar* në vitin 1948 ishte 11,878. Pastaj vazhdon të ketë tendencë rritjeje, duke arritur pikën më të lartë në vitin 1990 me 42,025. Pas kësaj periudhe shtimi natyral filloi të bie. Në vitin 2006 shtimi natyral i shqiptarëve ishte 25,905.

Shtimi natyral tek *etniteti serb* në vitin 1948 ishte 4,210. Në vitin 1954 shtimi natyral tek komuniteti serb shënoi pikën më të lartë të rritjes me 6,120. Në vitet e mëvonshme shënon një rënie të ndjeshme, për të vazhduar në vitin 1998 me 1,168 persona.

*Etniteti turk* në vitin 1948 shtimin natyral e kishte gjithsej 35, për të vazhduar me rritje , ku në vitin 1957 arriti në 445. Ky numër në vitin 2006 ishte 127 persona.

*Etniteti rom* në vitin 1948 shtimin natyral e kishte 262. Gjatë gjithë kohës kishte tendencë rritjeje, kështu që në vitin 1988 arritën shifrën 964. Në vitin 2006 kjo shifër ishte 222 persona.

**Tabela nr.7**

Lindjet, vdekjet dhe shtimi natyral sipas viteve të regjistrimit të popullsisë dhe përkatësisë etnike																		
Viti	Lindjet						Vdekjet						Shtimi natyral					
	Gjithsej	Shqiptarë	Serbë	Turq	Rom	Të tjerë	Gjithsej	Shqiptarë	Serbë	Turq	Rom	Të tjerë	Gjithsej	Shqiptarë	Serbë	Turq	Rom	Të tjerë
1948	27792	18899	6698	56	417	1723	10324	7020	2488	21	155	640	17468	11878	4210	35	262	1083
1953	34595	23525	8337	69	519	2145	16726	11374	4031	33	251	1037	17869	12151	4306	36	268	1108
1961	40561	29931	7115	316	0	3199	11759	9139	1931	102	0	587	28802	20792	5184	214	0	2612
1971	47060	38923	5111	213	352	2461	10312	7979	1558	87	60	628	36748	30944	3553	126	292	1833
1981	48111	41263	3675	228	714	2231	9677	7457	1445	60	119	596	38434	33806	2230	168	595	1635
1991	52263	45313,01	3368	266	1010	2306	8526	6432	1324	54	152	565	43737	38881	2044	212	859	1741
2006	34187	32977	8	156	247	799	7479	7072	96	29	25	257	26708	25905	-88	127	222	542

Nataliteti, mortaliteti dhe Shtimi natyral sipas viteve të regjistrimit të popullsisë dhe përkatësisë etnike																		
Viti	Lindjet						Vdekjet						Shtimi natyral					
	Gjithsej	Shqiptarë	Serbë	Turq	Rom	Të tjerë	Gjithsej	Shqiptarë	Serbë	Turq	Rom	Të tjerë	Gjithsej	Shqiptarë	Serbë	Turq	Rom	Të tjerë
1948	37,9	37,9	37,9	42,1	37,1	37,9	14,1	14,1	14,1	15,6	13,8	14,1	23,8	23,8	23,8	26,5	23,3	23,8
1953	42,4	44,8	43,9	2,0	43,6	39,0	20,5	21,7	21,2	1,0	21,1	18,9	21,9	23,2	22,7	1,0	22,5	20,1
1961	42,1	46,3	31,3	12,3	0,0	52,1	12,2	14,1	8,5	4,0	0,0	9,6	29,9	32,2	22,8	8,3	0,0	42,5
1971	37,8	42,5	22,4	17,4	24,1	34,0	8,3	8,7	6,8	7,1	4,1	8,7	29,5	33,8	15,6	10,3	20,0	25,3
1981	30,4	33,6	17,5	18,2	20,9	22,0	6,1	6,1	6,9	4,8	3,5	5,9	24,3	27,6	10,6	13,4	17,4	16,1
1991	26,7	28,4	17,3	25,5	22,1	21,0	4,4	4,0	6,8	5,1	3,3	5,1	22,4	24,4	10,5	20,3	18,8	15,9
2006	16,3	17,1	0,1	18,6	10,5	32,2	3,6	3,7	0,9	3,5	1,1	10,4	12,7	13,4	-0,8	15,1	9,4	21,9

### Nataliteti

Nataliteti në vitin 1948 në Kosovë ishte 37.9 o/oo. Në vitin 1953 dhe 1961 nataliteti ishte 42.4 respektivisht 42.1 o/oo dhe më pas fillon rënia e tij nëpër vite për të arritur në vitin 2006 në 16.3 o/oo.

Nataliteti sipas strukturës etnike pothuajse kishte të njëjtin trend sikurse vlerat e përgjithshme.

Nga të dhënat e tabelës së mësipërme vërehet se në vitet e fundit nataliteti më i lartë në Kosovë është tek etniteti shqiptar, turk, rom, etj.

### Mortaliteti

Mortaliteti në vitin 1948 në Kosovë ishte 14.1 o/oo. Në vitin 1953 mortaliteti ishte më i lartë 20.5 o/oo dhe se që nga ky vit ai shënon rënie, dhe në vitin 2006 bie në 3.6 o/oo.

### Shtimi natyral i shprehur në numra relativ

Shtimi natyral në vitin 1948 në Kosovë ishte 23.8 o/oo, duke arritur pikën më të lartë në vitin 1961 dhe 1971 me 29.9 o/oo. Pastaj fillon rënia dhe në vitin 2006 shtimi natyral bie në 12.7 o/oo.

## Numri i popullsisë në Kosovë dhe struktura etnike sipas regjistrimit të popullsisë 1981 dhe vlerësimit të vitit 1991

Regjistrimi i vitit 1981 merret si regjistrim i fundit valid në Kosovë.

Në regjistrimin e popullsisë të vitit 1981 dhe vlerësimit të vitit 1991 Kosova kishte numër të popullsisë prej 1,584,440 respektivisht 1,956,196 banorë. Gjatë këtyre dy regjistrimeve Kosova kishte këtë strukturë të përbërjes etnike.

Tabela nr.8

Etniciteti	1981		1991		Diferenca
	Gjithsej	%	Gjithsej	%	
Shqiptarë	1.226.736	77,4	1.596.072	81,6	369.336
Serbë	209.798	13,2	194.190	9,9	-15.608
Turq	12.513	0,8	10.445	0,5	-2.068
Rom	34.126	2,2	45.745	2,3	11.619
Tjerë	101.267	6,4	109.744	5,6	8.477
Gjithsej	1.584.440	100	1.956.196	100	371.756

Në mes këtyre dy periudhave të regjistrimit struktura etnike ka pësuar ndryshime si në vijim:

*Etniciti shqiptar* ka pasur rritje prej 369,336 banorë apo 26%,

*Etniciti serb* ka pasur rënie 15,608 banorë apo 7.4%,

*Etniciti turk* ka pasur rënie për 2,068 banorë apo 16.5%,

*Etniciti rom* ka pasur rritje për 11,619 banorë apo 34%,

*Te tjerët* kanë pasur një rritje prej 8,477 banorë apo 8.4%.

Tabela nr.9

Etniciteti	1981	%	1991	%	Dallimi 1981-1991	Levizjet vjetore-	Shtimi per periudhen 15
Shqiptarë	1.226.736	77,4	1.596.072	81,6	369.336	36.934	554.004
Serbë	209.798	13,2	194.190	9,9	-15.608	-1.561	-23.412
Turk	12.513	0,8	10.445	0,5	-2.068	-207	-3.102
Rom	34.126	2,2	45.745	2,3	11.619	1.162	17.429
Tjerë	101.267	6,4	109.744	5,6	8.477	848	12.716
Gjithsej	1.584.440	100	1.956.196	100	371.756	37.176	557.634

Duke u bazuar në këto trende të lëvizjes së popullsisë (*duke marrë si bazë lëvizjet në dhjetëvjeçarin 1981-'91*) pa llogaritur ndikimin e faktorëve tjerë të lëvizjeve të popullsisë, në vitin 2006 do të kishim këtë përbërje etnike në Kosovë: shqiptarë 2.150.076, serbë 170.778, turq 7.343, rom 63.174 dhe tjerë, rreth 122,460 apo gjithsej 2.513.830 banorë.

### Disa krahasime në mes regjistrimeve dhe shtimit natyral

Nga të dhënat që janë publikuar në këtë hulumtim vërehet se ka pasur një disproporcion në mes të shtimit natyral dhe regjistrimeve.

Kosova në vitin 1948 kishte 733,034 banorë, gjersa në vitin 1953 kishte 815,908 banorë apo kishte një rritje prej afro 82,874 banorë, brenda kësaj periudhe. Në qoftë se shikojmë shtimin natyral gjatë kësaj periudhe, shihet se ka pasur një shtim të popullsisë prej 94,633 banorë, pra rreth 11,759 banorë, mungojnë në regjistrim.

Në vitin 1961 Kosova kishte 963,988 banorë apo kishte një rritje prej 148,080 banorë krahasuar me vitin 1953. Kur regjistrimit paraprak ia shtojmë shtimin natyral gjatë kësaj periudhe prej 188,132 banorë, atëherë Kosova është dashur ti ketë 1,004,040 banorë, pra diferenca është prej 40,052 banorë.

Në vitin 1971 Kosova kishte 1,243,693 banorë, apo kishte një rritje prej 279,705 banorë krahasuar me vitin 1961. Kur regjistrimit paraprak ia shtojmë shtimin natyral gjatë kësaj periudhe prej 313,831 banorë, atëherë, Kosova është dashur t'i ketë 1,277,819 banorë, pra mungojnë në regjistrim 34,126 banorë.

Në vitin 1981 Kosova kishte 1,584,440 banorë, apo kishte një rritje prej 340,747 banorë krahasuar me vitin 1971. Kur regjistrimit paraprak ia shtojmë shtimin natyral gjatë kësaj periudhe prej 394,124 banorë, atëherë, Kosova është dashur t'i ketë 1,637,817 banorë, d.m.th. mungojnë në regjistrim 53,377 banorë.

Në vitin 1991 Kosova kishte 1,956,196 banorë, apo kishte një rritje prej 371,756 banorë krahasuar me vitin 1981. Kur regjistrimit paraprak ia shtojmë shtimin natyral gjatë kësaj periudhe prej 432,643 banorë, atëherë, Kosova është dashur t'i ketë 2,017,083 banorë, pra nuk janë përfshirë rreth 60,887 banorë.

***Kur shikohet shtimi natyral që nga viti 1948 deri me tani (2006) Kosova është shtuar me 1,953,509 banorë, dhe kur kësaj i shtohet numri i popullsisë i vitit 1948 prej 733,034 banorë, fitojmë numrin e popullsisë prej 2,686,543 banorë.***

***ESK ka bërë vlerësimin e numrit të popullsisë rezidente (që gjendet në Kosovë dhe atë që mungon nga vendi i përhershëm më pak se 12 muaj) që është vlerësuar të jetë rreth 2,100,000 banorë si popullsi rezidente dhe numri i popullsisë që gjendet jashtë Kosovës duhet të jetë rreth 586,543 banorë.***

## **Regjistrimi i vitit 1981 dhe përgatitjet për regjistrimin e ardhshëm**

Regjistrimi i fundit në Kosovë është bërë në vitin 1981 .

Regjistrimi i vitit 1991 i organizuar nga ish EFS, për Kosovën ka bërë vetëm një vlerësim pasi popullsia shqiptare e ka bojkotuar regjistrimin. Sipas disa analistëve që merren me statistika, regjistrimi i vitit 1991 mund të ketë një besueshmëri deri 90% të të dhënave. Edhe përkundër përgatitjeve që ishin bërë për mirëvajtjen e regjistrimit të vitit 1991 nga punëtorët e ESK dhe komisioneve të ndryshme komunale, më datë 23. gusht 1990 largohen nga ESK 128 punëtorë shqiptarë.

Që nga ajo kohë njeherit ndërpriten edhe shumë aktivitete të ESK duke përfshirë edhe bojkotimin e regjistrimit të vitit 1991. Në vitin 1999, më datë 2 gusht, kthehen punëtorët e dëbuar më parë.

Në vitin 2003 stafi i ESK në bashkëpunim me institucionet vendore dhe ndërkombëtare ka përgatitur ligjin mbi regjistrimin e popullsisë, ekonomive familjare dhe banesave.

Ministria e Shërbimeve Publike (MSHP) me qëllim të zbatimit të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2004/53 për shpalljen e Ligjit të miratuar nga Kuvendi i Kosovës Nr. 2003/16 për Regjistrimin e popullsisë, ekonomive familjare dhe banesave në Kosovë, në janar të vitit 2005 ka filluar përgatitjet në Zyrën e regjistrimit të popullsisë, ekonomive familjare dhe banesave e cila është në kuadër të Entit Statistikor të Kosovës (ESK-së).

Në vitin 2005 (nëntor) dhe 2006 (tetor-nëntor) janë mbajtur dy regjistrime testuese për të parë nivelin e përgatitjeve për regjistrimin e përgjithshëm.

Regjistrimi i fundit testues (tetor-nëntor-2006) është monitoruar nga EUROSTAT-i dhe ne baze të raporteve që janë bërë, pothuaj të gjitha përgatitjet e duhura për mbajtjen e regjistrimit të përgjithshëm. Datën e mbajtjes së regjistrimit të popullsisë e cakton parlamenti i Kosovës, andaj ESK është në pritje të caktimit të datës së regjistrimit të përgjithshëm.

Në Kosovë, nevoja për regjistrimin e popullsisë është shumë e madhe. Zhvillimet kryesore me interes për vendin gjatë viteve të shkuara nuk janë percjellur, meqenëse pas lëvizjeve të mëdha të popullatës nuk është bërë Regjistrimi i popullsisë.

Ngjarjet e viteve të fundit kanë ndikuar në masë të madhe në shtrirjen gjeografike të popullatës. Shumë persona janë shpërngulur prej vendeve rurale nëpër qytete. Disa të tjerë kanë shkuar në botën e jashtme, ndërsa shumë të huaj janë vendosur në Kosovë. Ekzistojnë ndryshime të theksuara në sferën e fertilitetit, sepse prindërit tani mesatarisht kanë më pak fëmijë sesa më parë.

Çështjet e mungesës së informatave bazike për popullsinë shpesh paraqiten në agjendën kombëtare, ndërsa diskutimet drejt organizimit dhe zbatimit të një regjistrimi të ri të popullsisë, ekonomive familjare dhe banesave në Kosovë është prezent tash e një kohë dhe si i tillë konsiderohet prioritet kombëtar.

Implementimi i Regjistrimit është shumë i rëndësishëm për përcaktimin e synimeve sociale, ekonomike dhe të planeve zhvillimore dhe si i tillë është me interes të të gjithëve, duke filluar nga komunat, të cilat kanë nevojë për të dhëna që mund të përdoren për planifikim dhe zhvillim të shërbimeve në nivel lokal, qendror etj të cilëve iu mungon një emërues i përbashkët për llogaritjen e të ardhurave dhe të prodhimit për kokë banori.

Regjistrimi do të jetë një investim afatgjatë për gjithë sistemin statistikor, nga njëra anë në kuptim të ndërtimit të kapaciteteve dhe institucioneve, kurse nga ana tjetër, do të mundësojë krijimin e një baze për një sistem të besueshëm të statistikave aktuale jetësore dhe të statistikave mbi popullsinë dhe hulumtimet e tjera në bazë të mostrave.

Regjistrimi i ardhshëm i popullsisë, ekonomive familjare dhe banesave në Kosovë do të jetë regjistrimi i par, i cili do të implementohet në mënyrë të pavarur nga ESK.

Regjistrimi gjithashtu do të përmirësojë kapacitetet e ESK-së për implementimin e të gjitha fazave të regjistrimeve dhe hulumtimeve të ardhshme të popullsisë, e që do të mundësojë zhvillimin e një kornize të mostrimit kryesor, si dhe infrastrukturën bazike të gjithë sistemit statistikor, në përputhje me të gjitha rekomandimet dhe standardet e njohura evropiane dhe ndërkombëtare.

Grumbullimi i të dhënave për disa variabla është i pamundur pa pasur një regjistrim të përgjithshëm. Ndryshimet e shumta që kanë ndodhur pas viti 1999 edhe përkundër disa hulumtimeve statistikore është e vështirë të jepen të dhëna të afërta në aspektin socio-ekonomik.







## Enti i Statistikës së Kosovës përshkrim i shkurtër

**Enti i Statistikës së Kosovës**, është Ent profesional, vepron që nga viti 1948 dhe ka kaluar disa faza historike, i strukturuar sipas rregullimit shtetëror të asaj kohe.

Më 2 Gusht 1999, Enti ka rifilluar punën profesionale, si i pavarur në kuadër të Ministrisë së Shërbimeve Publike. Enti financohet nga Buxheti i Konsoliduar i Kosovës dhe donatorë për projekte të veçanta.

**Enti i Statistikës së Kosovës** vepron sipas Rregullores 2001/14 e cila ka hyrë në fuqi me 2 Korrik 2001. Një Master Plan afatmesëm është duke u përgatitur për zhvillimin e sistemit statistikor kompatibil me Statistikat Evropiane.

**Struktura organizative e ESK-së**, katër *Departamente prodhuese* (Departamenti i statistikave ekonomike dhe llogarive kombëtare, Departamenti i statistikave të popullsisë, Departamenti i statistikave sociale dhe Departamenti i statistikave të bujqësisë dhe ambientit), *shtatë Zyra Rajonale* (Gjakovë, Gjilan, Mitrovicë, Pejë, Prizren, Prishtinë dhe Ferizaj), *dy Departamente mbështetëse* (Departamenti i metodologjisë dhe teknologjisë informative dhe Departamenti i administratës), si dhe *Zyra e regjistrimit të popullsisë*, përbëjnë ndërtimin struktural të ESK-ës.

Të punësuar janë gjithsej 134 punëtorë, prej tyre, 96 (71.6%) në seli të Entit, gjersa në Zyrat Rajonale, 38 (28.4%) .

Kemi mbështetje dhe bashkëpunim profesional me institucionet ndërkombëtare.

Enti i Statistikës së Kosovës ka një terren krejtësisht të mbuluar në shkallë vendi. Për implementim e Anketave në terren përdorim mostrën dhe metodologjinë adekuate. Gjatë grumbullimit të raporteve nga njësitë raportuese angazhohen; profesionistë, teknikë, administratorë, civilë të zyrave të vendit, regjistruar terreni nga Zyrat Rajonale.

Një ekip i ekspertëve vendorë dhe ndërkombëtar janë duke punuar në projektin e regjistrimit të popullsisë.

**Misioni i Entit**, është që të përmbush nevojat e përdoruesve me të dhëna statistikore objektive dhe analiza të rregullta në mënyrë që të përkrah departamentet qeveritare, t'u sigurojë informata të duhura për vendim-marrësit si dhe përdoruesit tjerë në Kosovë.

- **Adresa: Enti i Statistikës së Kosovës, Rr. "Zenel Salihu" Nr.4, Prishtinë**
- **Telefonat:**  
**Qendra kryesore: +381 (0) 38 235 111**  
**Drejtori: +381 (0) 38 235 545 ose +381 (0) 38 504 604 lok. 6572**
- **Fax: +381 (0) 38 235 033**
- **E-mail: [population@ks-gov.net](mailto:population@ks-gov.net)**
- **Ueb-faqe: [www.ks-gov.net/esk](http://www.ks-gov.net/esk)**